



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/319
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K4/I37-2 Prot.
Nr. Dok. 202502724/2

Tiranë _30_/_07_/_2025

Lënda: Rekomandime për inspektimin e kryer në Komisaratin e Policisë Vau Dejes.

Drejtuar: Z. Gentian BERBERI
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë

SHKODËR

Z. Arif PËRGJEGJI
Shef i Komisariatit të Policisë

VAU DEJËS

Për dijeni: Z. Drejtues Madhor Ilir Proda
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë të Shtetit

TIRANË

Të nderuar,

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin e deritanishëm dhe duke vlerësuar angazhimin dhe punën e të gjithë stafit të institucionit që ju drejtoni, si dhe frymën e mirë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis institucioneve tona, në vijim po ju njohim mbi gjetjet e inspektimit që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në Komisaratin e Policisë Vau Dejes më datë 07.05.2025.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, seksion pranë Avokatit të Popullit, në vijim Mekanizmi Kombëtar, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, dhe nenin 81 të ligjit nr. 81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve" kreu një inspektim në Komisaratin e Policisë Vau Dejes.

Inspektimi u krye sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues morën pjesë z. Vullnet Topalli dhe z. Hazbi Selita, me detyrë Nd/Komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1720, datë 20.11. 2023 për miratimin e procedurës standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*” dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”. Inspektimi ishte i paparalajmëruar.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i vitit të kaluar, ka detyrimin ligjor t’ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, që do të gjeni më poshtë:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetasit e privuar nga liria, grupi i inspektimit u takua me shefin e Komisarariatit z. Arif Përgjegji i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim të takimit, z. Përgjegji informoi grupin e inspektimit, lidhur me kushtet e ambienteve të shoqërimit të këtij Komisaritati sipas procedurave standarde dhe për rritjen e performancës së punonjësve të policisë për respektimin e të drejtave ligjore të shtetasve të shoqëruar, arrestuar/ndaluar.

Në Komisariatin e Policisë Vau i Dejes, oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e tyre. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta intervistimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.

Nga monitorimi u konstatua se në ambientet e komisarariatit Vau i Dejes kishte 3 zyra pune, një zyrë pune për shefin e komisarariatit një zyrë pune për shefin e krimeve dhe 3 oficerëve të policisë gjyqësore si dhe zyra e punës për 8 specialistë të policimit në komunitet (SPZ).

Nga monitorimi që u bë zyrave të oficerëve të policisë gjyqësore, nuk u gjetën sende prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Në këtë Komisarariat kishte një dhomë magazinë për administrimin dhe ruajtjen e provave materiale, provat materiale të administruara gjatë procedimeve penale nga specialistët e krimeve si dhe materialet e tjera ishin të paketuara dhe emërtuara.

Avokati i Popullit është i ndërgjegjshëm se disa rekomandime kërkojnë ndërhyrje infrastrukturore dhe buxhetore që nuk varen nga njësia vendore, por çdo komisarariat duhet të demostrojë se ka qenë konsekuent në kërkimin e fondeve, në lidhje për ndërtimin e dhomave të shoqërimit të ndara me vete për persona të rritur, femra dhe të mitur në konflikt me ligjin sipas procedures standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që*

shoqërohen në mjediset e policisë”, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit¹.

Në përfundim të inspektimit, grupi monitorues konstatoi se, në ambientet aktuale në Komisariatit e Policisë Vau Dejes, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika dhe konkretisht:

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

të ndërtuar sipas kërkesave të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, dhe procedurave standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, ku parashikohet se dhomat e shoqërimit duhet të jenë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për persona të rritur, për femra dhe të miturit

Në Komisariatit e Policisë Vau-Dejës, nuk kishte ambiente të shoqërimit.

Sipas bisedës me Shefin e Komisariatit Vau Dejës, personat e shoqëruar qëndronin në zyrat e punës së oficerëve të policisë gjyqësore, deri në përfundim të veprimeve procedurale nga ana e punonjësve të policisë, për sqarimin e rrethanave për të cilin është iniciuar ndalimi i përkohshëm në polici, ku punonjësit të policisë i paraqiten dy mundësi: të lirojë menjëherë personin me masen e ndalimit të përkohshëm policor ose të kryejë ndalimin/ arrestimin e tij, në bazë të nenit 253/2 dhe nenit 251/3 të kodit të Procedurës penale dhe dërgimin e tyre menjëherë në dhomat e sigurisë të Komisariatit të Policisë Shkodër.

Mungesa e dhomave të shoqërimit për shtetasit në konflikt me ligjin është një nga problematikat që paraqitet në këtë komisarariat, duke sjellë si pasojë mos garantimin e lirive, të drejtave dhe standardeve që kanë të bëjnë me shoqërimin, mbajtjen dhe trajtimin në mjediset e policisë, si dhe nevojave fizike, profesionale dhe psikologjike, kur merren vendime që prekin ndonjë aspekt të ndalimit të tyre.

Dhoma e shoqërimit në Komisariatit e Policisë Vau Dejës duhet të ishte ndërtuar siç është parashikuar në Kreun VII, pika 4 të procedurave standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, ku parashikon qartë përcaktimin e rregullave teknike dhe standardeve që kanë të bëjnë me shoqërimin, mbajtjen dhe trajtimin e personave në mjediset e policisë dhe atyre të institucioneve/organeve urdhërdhënëse, si dhe të detyrimeve ligjore që kanë punonjësit e policisë për respektimin e garantimin e të drejtave që ju njeh ligji këtyre personave.

Në ambientin e hyrjes së komisarariatit kishte një zyrë pune për specialistin e zyrës së informacionit, në të cilën administroheshin dokumentacionet e nevojshme lidhur me personat e shoqëruar.

¹ Kreu VI, pika 4 gërmat b dhe c “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, miratuar me Urdhrin nr.894, datë 19.07.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Përgjatë inspektimit konstatuam se personat e shoqëruar në mjediset e policisë, vijonin të intervistoheshin në zyrat e punës të punonjësve të policisë dhe jo në zyrën e intervistimit. Zyrat e punës të punonjësve të policisë, nuk ishin të monitoruara me sistemin e kamerave për të vëzhguar veprimet procedurale që kryejnë me personat e shoqëruar. Avokati i Popullit e vlerëson shkelje të rëndë ligjore për sa kohë që infrastruktura, edhe pse jo e plotë ekziston.

Gjithashtu zyrat e punës të punonjësve të policisë, në të cilat intervistoheshin personat e shoqëruar, nuk kishin sistem ngrohje/ftohje dhe tualeti që përdorej për stafin e komisariatit përdorej dhe për personat e shoqëruar, i cili ishte i përbashkët.

Grupi i inspektimit konstatoi *se mungonte sistemi i monitorimi me kamera* për mbajtjen në vëzhgim të korridoreve të ambienteve të Komisarariatit.

Mungesa e sistemit të monitorimit me kamera të komisariatit, mund të përbëjë shkak për përdorimin e mjeteve dhe metodave jo të përshtatshme për shoqërimin, mbajtjen dhe trajtimin e personave në mjediset e policisë, si dhe për respektimin dhe garantimin e të drejtave që ju njeh ligji këtyre personave. Mbikëqyrja me kamera e të gjitha mjediseve në komisariate, përveç atyre mjediseve ku cenohet privatësia, është vlerësuar nga ana jonë si një proces thelbësor për tre arsye:

Së pari, mbikëqyrja me kamera ka një efekt parandalues për veprime të kundërligjshme që mund të kryhen, si nga ana e punonjësit të policisë së shtetit ashtu dhe nga vetë të shoqëruarit.

Së dyti, mbikëqyrja me kamera dokumenton shumicën e ngjarjeve brenda ambienteve të komisariateve, si dhe jep garanci për një gjykim objektiv dhe të paanshëm për masat disiplinore apo penale që duhet të merren ndaj individëve përgjegjës.

Së treti, dokumentimi filmik është një material mbi të cilin mund të konsultohen mjaft të dhëna apo pretendime për trajtimin e të shoqëruarve dhe mund të nxirren përfundime të vlefshme dhe të paanshme në rekomandimet apo raportet përkatëse që hartohen nga institucionet monitoruese të pavarura.

Në kushtet e vendndodhjes së komisariatit, si dhe për të garantuar sigurinë e personave të shoqëruar, është i domosdoshëm instalimi i sistemit të kamerave në korridoret e Komisarariatit të Policisë Vau-Dejës, siç parashikon Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022 procedurat standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, ku thuhet se: *“Të gjitha ambientet e shoqërimit monitorohen me sisteme të kamerave (përfshijë tualetin) si ambientet e brendshme të dhomave të shoqërimit, korridori i tyre dhe pjesa e jashtme e dhomave të shoqërimit, të cilat lidhen dhe trasmentojnë pamje/imazhe në monitor të vendosur në ambientin e shoqërimit të sallës së komandimit/shërbimit të informacionit të DPV, komisariate, dhe stacionet e policisë”*.

Gjatë inspektimit, u konstatua se në këtë Komisarariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në pikën 6 të nenit 19² e ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, si dhe në Kapitullin VII, pika a.3.4³ të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit të çështjes përkatëse.

Në Komisariatin e Policisë Vau Dejës gjatë periudhës 01.01.2025 deri më 07.05.2025 ishin të shoqëruar dhe të evidentuar në regjistrin e shoqërimit 25 persona, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 19 dhe 25/1 të ligjit nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”, ku të gjithë të shoqëruarit ishin shtetas madhorë burra. Në momentin e inspektimit nuk kishte asnjë shtetas në Komisariatin e Policisë Vau Dejës

Gjithashtu, përgjatë inspektimit konstatuam se personave të shoqëruar nga policia nuk iu jepej informacioni për të drejtat e tyre në formë shkresore, që nga fillimi i privimit të lirisë, për të siguruar informim të qartë në lidhje me të drejtat ligjore / procedurale që ata kanë.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës sugjeron dhënien e kartës të drejtave që në momentin e hyrjes në komisarariat. Rekomandimi i MKPT-së, në përmbajtjen e tij nënkupton që karta me të drejtat që gëzojnë personat kur hyjnë në mjediset e policisë, duhet t’u jepet edhe personave që mbahen në dhomat e shoqërimit, pra që në momentet e para të privimit të lirisë. Pasi këtyre personave iu kufizohet liria deri në 5 orë (maksimumi) qëndrimi në dhomat e shoqërimit, ata merren në pyetje nga specialistët e policisë dhe kanë të drejtën për njoftimin e familjarëve të tyre, të drejtën për qasje me avokat mbrojtës, etj.

Avokati i Popullit inkurajon pajisjen e qytetarëve me “Kartën e të drejtave” në rast shoqërimi në polici, që është një dokument me të cilin duhet të njihet çdo qytetar që shoqërohet në një komisarariat policie. Nëpërmjet “Kartës së të drejtave” qytetari informohet mbi të drejtat e tij përballë institucionit të Policisë së Shtetit në mënyrë që të jetë i ndërgjegjshëm për çdo formë abuzimi apo tejkalimi të kompetencave të punonjësve të policisë kundrejt tij.⁴

² Pika 6, e nenit 19 të ligjit nr.82/2024 “Për Policinë e Shtetit” i cili parashikon se: “Punonjësi i policisë dokumenton veprimet e kryera me personin e ndaluar përkohësisht, sipas procedurave standarde të miratuara me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Një kopje e dokumentacionit i vihet në dispozicion personit të ndaluar përkohësisht.”

³ Urdhër nr.894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë” parashikon në pikat “a.3.3 - Proces verbal i veprimeve të kryera me personin e shoqëruar: a.3.4 “Procesverbali hartohet në dy kopje, një kopje e procesverbalit i jepet detyrimit personit të shoqëruar dhe kopja tjetër dorëzohet në sekretari/arshivën e njësisë policore.”

⁴ CPT u bën thirrje autoriteteve shqiptare të ndërmarrin hapa për të siguruar që personat e ndaluar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i heqjes së lirisë (domethënë, nga momenti kur ata janë të detyruar të qëndrojnë në polici).

Kjo duhet të sigurohet me dhënien e informacionit të qartë verbal që në fillim, për t’u plotësuar në rastin më të shpejtë (domethënë, menjëherë pas mbërritjes në ambientet e policisë) me sigurimin e fletës së informacionit të lartpërmendur. Personave në fjalë duhet t’u kërkohej të nënshkruajnë një deklaratë që vërteton se ata kanë marrë një kopje të fletës së informacionit.

Raporti CPT-së për Shqipërinë CPT/Inf (2019) 28 [par.24]. Konsulto: <https://rm.coe.int/168097986b>

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Në Komisarlatin e Policisë Vau i Dejës **nuk kishte ambiente të sigurisë** dhe personat e arrestuar/ndaluar dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisarlatit të Policisë Shkodër.

Regjistri i personave të shoqëruar, si dhe trajtimi i të shoqëruarve

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisarlatin Vau Dejës, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte plotësuar në zbatim të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, sipas tipit “Model nr.1”, konform procedurave standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë” miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022, e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar.

Personat e shoqëruar në mjediset e policisë, sipas dispozitave të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, regjistroheshin në këtë regjister nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezulton se koha e qëndrimit në gjendjen e shoqërimit të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri 5 orë në raste të veçanta.

Në zyrën e informacionit të Komisarlatit të Policisë Vau i Dejës mungonte regjistri më vete për evidentimin e të dhënave të personave të mitur të shoqëruar, në bazë dhe të rekomandimeve të përsëritura të Avokatit të Popullit për këtë qëllim si dhe referuar Procedurës Standarde të punës, “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, pika.a.5, Regjistrin e Evidentimit të Dhënave për Personat e Shoqëruar të Mitur dhe pjesë e pandarë e kësaj procedure (Lidhja model 5).

Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisarlat mungonte edhe regjistri për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 “Kërkesë/ankesat e të shoqëruarve, të ndaluarve dhe të arrestuarve” të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, por nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë. Referuar procedurës standarde ku përcaktohet se personi i shoqëruar ka të drejtë, “Të paraqesë kërkesa apo ankesa për mënyrën e shoqërimit, mbajtjes, trajtimit dhe respektimit të të drejtave nga personeli policor gjatë shoqërimit dhe mbajtjes në ambientet e policisë”.

Ambientet e intervistimit

Në Komisarlatin e Policisë Vau i Dejës punonjësit e policisë i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e punës të cilat nuk ishin të monitoruara me sistemin e kamerave për vëzhgimin gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga punonjësit e policisë.

Në Procedurën Standarde të Punës “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, me Urdhrin: nr. 894, dt. 19.07. 2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit përcaktohet qartë se: *Pranë dhomave të shoqërimit dhe pjesë të këtij sistemi projektohen dhe ndërtohen ambiente të posaçme si: i.1 Dhomë për intervistimin/marrjen në pyetje të personave të shoqëruar para se të akomodohen/futen në dhomat e sigurisë të DVP/komisarlatit të policisë (personat që do të arrestohen/ndalohen).*

i.1.1 Ky ambient përveç kushteve të përcaktuara për dhomat e shoqërimit duhet të plotësojë dhe këto kushte:

Të ketë të instaluara tavolinë pune dhe karrige për oficerin e policisë gjyqësore dhe pajisje elektronike për dokumentimin e veprimeve procedurale që kryhen nga OPGJ (kompjuter, printer, letër, etj).

Tavolinë pune dhe dy karrige për qëndrimin e avokatit mbrojtës dhe të personit të dyshuar/akuzuar i cili do të intervistohet, arrestohet/ndalohej, etj.

Instalohen sisteme dhe pajisje për regjistrimin elektronik audio dhe video të të gjitha veprimeve procedurale që kryhen me personin e shoqëruar nga oficerët e policisë gjyqësore, para se personi të akomodohet në dhomat e sigurisë të DVP/komisariatit të policisë si i arrestuar/ndaluar.

Avokati i Popullit e konsideron procesin e intervistimit të personit në një ambient më vete, që të jetë i monitoruar nëpërmjet sistemit të kamerave të sigurisë, si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi monitorimi filmik ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit ndaj tyre.

Në raportin drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e Komitetit për Parandalimin e Torturës në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023 është evidentuar qartë nevoja e krijimit të dhomave të intervistimit: “Në fakt, një strukturë e tillë mund të sigurojë një regjistrim të plotë dhe autentik të procesit të intervistimit, duke lehtësuar në masë të madhe hetimin e çdo pretendimi për keqtrajtim. Ky fakt është në interes si të personave që janë keqtrajtuar nga policia, ashtu edhe të punonjësve të policisë që janë përballur me pretendime të pabaza se janë përfshirë në keqtrajtme fizike apo presione psikologjike.

Në parim, regjistrimi audio-vizual duhet të mbulojë të gjitha fazat e marrjes në pyetje nga policia, duke përfshirë dhënien e informacionit për të drejtat në fillim të intervistës. Kjo do të sigurojë që marrja në pyetje nga ana e policisë të kryhet në përputhje me ligjin dhe do të ndihmojë në parandalimin e çdo praktike të nënshtrimit të personave të ndaluar në marrje në pyetje joformale përpara marrjes në pyetje zyrtare”.

CPT inkurajon autoritetet shqiptare të zgjerojnë aplikimin e regjistrimit audio-vizual të intervistave të policisë për marrjen në pyetje të të gjithë personave të shoqëruar”⁵.

Komisariati i Policisë Vau Dejes në kushtet aktuale nuk posedon hapësirë të posaçme për komunikimin apo intervistimin me persona të mitur, ndaj MKPT e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se bisedat me fëmijët dhe pyetja e tyre duhet të realizohen në një ambient që duhet të jetë i përshtatur në mënyrë të posaçme për zhvillimin e intervistimeve me fëmijët, pasi nga intervistimi i tyre në kushtet aktuale mund të shkaktohen pasoja të rënda deri në trauma tek të miturit që janë në konflikt me ligjin.

⁵ Electronic recording of police intervistës (Regjistrimi elektronik i marrjes në pyetje nga ana e policisë) fq.13, <https://rm.coe.int/1680ae233b>.

Ndihma juridike dhe psikologjike

Përgjatë inspektimit u konstatua se ishte një listë e afishuar në ambientet e komisariatit ku mund të evidentoheshin avokatët kryesisht. Punonjësit e policisë na bënë me dije se avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë Shkodër, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale. Ndërsa psikologu sigurohej në bashkëpunim me Bashkinë e Vaut Dejës.

Sipas informacionit, përgjithësisht avokati paraqitej në mjediset e policisë jo më vonë se 1 deri 2 orë nga momenti i njoftimit nga personeli i shërbimit ose nga specialistët e policisë të ngarkuar për kryerjen e veprimeve procedurale me të shoqëruarin apo të arrestuarin e dyshuar për kryerjen e veprës penale. Në regjistrin ku evidentohen takimet e të shoqëruarve me avokatin mbrojtës, shënohej emri dhe mbiemri i avokatit, si dhe ora e takimit, por jo ora e njoftimit.

Gjithashtu kjo problematikë është trajtuar në raport drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e CPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023.

CPT-ja bën rekomandime të hartuara për të përmirësuar funksionimin në praktikë të masave mbrojtëse ligjore. Kërkohej gjithashtu veprim për të siguruar që të gjithë personat e ndaluar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i heqjes së lirisë. CPT-ja gjatë vizitës në organet e policisë së Shtetit ka konstatuar se: *“Ka pretendime se oficerët e policisë kishin pranuar kërkesat e personave të shoqëruar arrestuar/ndaluar për avokat kryesisht vetëm pas një vonese të konsiderueshme, në mënyrë që të mund t’i pyesnin ata në mënyrë joformale për veprën e dyshuar pa praninë e një avokati”*⁶. Avokati i Popullit thekson se është e një rëndësie të veçantë afishimi në ambientin e shoqërimit të listës të përditësuar me avokatë mbrojtës të miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe organi i prokurorisë, me qëllim sigurimin e avokatëve kryesisht që nga momenti i privimit të lirisë të personit, në rastin kur i arrestuari/ndaluari nuk ka mundësi financiare të mbrohet me avokatë mbrojtës.

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, ata shoqëroheshin për në ambientet e sigurisë të Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, për kryerjen e veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore të seksionit për të miturit dhe në praninë e detyrueshme të kujdestarit ligjor, avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut.

Gjatë inspektimit u konstatua se, në hyrje të komisariatit ishin afishuar kartat me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë, si dhe të personave të ndaluar/arrestuar në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

Megjithatë mbeteshin ende të afishuara posterat e vjetra me të drejtat e personave të shoqëruar në mjediset e policisë dhe këto postera afatin maksimal të shoqërimit e kishin 10 orë. Për pasojë në shumë raste mund të kthehet në keqinformim të personave të shoqëruar. Në ligjin e ri *“Për Policinë e Shtetit”*⁷ përcaktohet se afati maksimal i

⁶ <https://rm.coe.int/1680ae233b>, fq nr.3, raport drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e KPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023.

⁷ Ligji i ri nr.82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, i cili ka hyrë në fuqi në datë 23.08.2024.

shoqërimit është **5 orë**. Afishimi i këtyre kartave ndihmon në rritjen e transparencës dhe ndihmon qytetarët të kuptojnë se si të mbrojnë të drejtat e tyre gjatë qëndrimit me policinë. Duke qenë se ky është një hap i rëndësishëm drejt ndërtimit të besimit mes publikut dhe institucioneve të rendit, do duhet zëvendësimi i tyre sa më shpejt me postera të rinj.

Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në pikën 6 të nenit 19 të ligjit nr.82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Në rastet kur të shoqëruarit paraqesin probleme shëndetësore, ata i shoqërojnë në Qendrën Shëndetësore Vau Dejës, për të marrë ndihmën mjekësore.

Sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”, me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për ndërtimin e dhomave të shoqërimit në Komisariatin e Policisë Vau i Dejës të ndara më vete për gratë, meshkujt madhorë dhe të miturit, sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 82 /2024 “Për Policinë e Shtetit”, dhe procedurës standarde dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, ku parashikohet se dhomat e shoqërimit duhet të jenë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridoreve të Komisariatit Vau i Dejës.
3. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e një zyre për intervistimin apo marrjen në pyetje të shtetasve gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e Policisë Gjyqësore, e pajisur me kamera audio-vizive.
4. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave të posaçme për intervistim me persona të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.

5. Marrjen e masave të menjëhershme, për pajisjen me një regjistër të posaçëm, vetëm për të miturit në konflikt me ligjin në ambientet e dhomave shoqërimit të Komisarariatit të Policisë në Vau i Dejës.
6. Marrjen e masave për zëvendësimin e posterave të afishuar në ambientet e komisarariatit me posterat e rinj ku referuar ligjit nr. 82/2024 për Policinë e Shtetit koha maksimale e mbajtjes së personit në shoqërim është 5 orë.
7. Marrjen e masave për hapjen dhe vënien në funksion të regjistrit të kërkesë/ankesave për shtetasit e shoqëruar/ndaluar në ambientet e Komisarariatit të Policisë në Vaun e Dejës sipas parashikimeve ligjore në fuqi.
8. Dhënia e kartave të të drejtave në momentin e hyrjes në komisarariat në formë shkresore, që nga fillimi i privimit të lirisë, për të siguruar informim të qartë në lidhje me të drejtat ligjore / procedurale që personat e shoqëruar kanë.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihem në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të Ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

**KOMISIONERI
i Mekanizmit Kombëtar
për Parandalimin e Torturës
(MKPT)**

**Ahmet PRENÇI
dv**